

Tiranë, më 3 Tetor 2022

## KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

### SUBJEKT AUDIOVIZIV PËR TRANSMETIMIN E NJË SPOTI TELEVIZIV NDËRGJEGJËSUES DHE INFORMUESE MBI ROLIN E KUVENDIT DHE RËNDËSINË E ANGAZHIMIT TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË MEKANIZMAT E VËNIES NË LËVIZJE TË KUVENDIT

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të implementimit të grantit të akorduar në zbatim të projektit “Për mbështetjen e Kuvendit dhe Edukimit Qytetar (PACEP)”, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e zbatuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI), shpall thirrjen për angazhimin e një subjekti audioviziv për transmetimin e një spot televiziv ndërgjegjësues dhe informues mbi rolin e Kuvendit dhe rëndësinë e angazhimit të organizatave të shoqërisë civile në mekanizmat e vënies në lëvizje të Kuvendit.

Spoti televiziv i cili do të transmetohet ka një sekuençë gjatësie kohore rreth **4-5 minuta**.

Subjekti duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- Televizioni duhet të jetë televizion kombëtar ose të ketë shtrirje të shikueshmërisë në shumicën e qyteteve të vendit;

KShH inkurajon subjektet tregatë/individët e interesuar që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al), deri në datën 7 Tetor 2022, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Ofertën Financiare të firmosur (në lekë me TVSH) për:
  - Transmetimin e videos gjatë periudhës Tetor-Nëntor 2022
  - Ofertën financiare për minutë për transmetimin 1 herë në ditë në prime time dhe jo prime time;
  - Ofertën financiare për minutë për transmetimin disa herë në ditë në prime time dhe jo prime time.
  - Nivelin e shikueshmërisë në prime time dhe jo në prime time.
2. Oferta financiare për secilën kategori duhet të përcaktohet në vlerën financiare për 1 minutë transmetimi.

Në varësi të ofertave të marra, do të realizohet përzgjedhja e mënyrës së transmetimit të videos.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin,

**Faleminderit,**

**Me konsideratë,**

**Komiteti Shqiptar i Helsinkit**